



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Komuna e Gjilanit
Opština Gnjilane
Municipality of Gjilan
Gilan Belediyesi

RR E G U L L O R E
PËR
PROCEDURAT DHE KRITERET E VENDOSJES SË PËRMENDOREVE,
SHTATOREVE, BUSTEVE DHE SIMBOLEVE

Gjilan, 2012

Në mbështetje të neneve 12.2 pika c) dhe 17 pika s) të Ligjit për vetëqeverisjen lokale Nr. 03/L - 040 GZ e Republikës së Kosovës nr. 28/2008) dhe nenit 39 nënparagrafi 1.3 të Statutit të Komunës së Gjilanit 01. nr. 16-53125 të datës 11.11.2011, Kuvendi Komunal i Gjilanit në mbledhjen e mbajtur më 09.02.2012, aprovoi:

R R E G U L L O R E N
P Ë R
PROCEDURAT DHE KRITERET E VENDOSJES SË PËRMENDOREVE,
SHTATOREVE, BUSTEVE DHE SIMBOLEVE

Dispozitat e përgjithshme

Neni 1

Qëllimi

Me këtë rregullore, përcaktohen procedura dhe kriteret për vendosjen e përmendoreve, shtatoreve, busteve dhe simboleve në hapësirat publike, brenda territorit të Komunës së Gjilanit.

Neni 2

Formimi i Komisionit dhe këshillit

1. Komisioni i përhershëm për përcaktimin e listës së lokacioneve dhe hapësirave për vendosjen e përmendoreve, shtatoreve, busteve dhe simboleve dhe këshilli i përhershëm komunal për vlerësim të meritave historike e shoqërore të personaliteteve dhe ngjarjeve nga territori i Komunës së Gjilanit dhe tërësia etnike shqiptare, por edhe nga tërë bota, emërohen nga ana e Kuvendit dhe duhet të pasqyrojnë përbërjen politike të Kuvendit, aspektin gjinor dhe profesional duke përfshirë edhe shoqërinë civile (me theks të veçantë edhe anëtarët nga shoqatat e dala nga lufta). Komisioni dhe Këshilli duhet të ketë 7 deri në 9 anëtarë.
2. Kuvendi i Komunës përmes Komisionit të Përhershëm të Komunës bënë përcaktimin e listës së lokacioneve dhe hapësirave për vendosjen përmendoreve, shtatoreve, busteve dhe simboleve të vendosura në hapësirat publike.

Neni 2

Komuna si autoritet publik është përgjegjëse për menaxhim e **procedurës së** vendosjes të përmendoreve, shtatoreve, busteve dhe simboleve të vendosura në hapësira publike.

Neni 3

Kriteret për vendosje

1. Në hapësira publike **të miratuara paraprakisht nga Kuvendi**, mund të vendosen përmendoret, shtatoret, bustet dhe simbolet sipas kriterëve të shënuara më poshtë:

- 1.1.** të ketë iniciativë për vendosjen e përmendoreve, shtatoreve, busteve ose të simboleve, nga qytetarët e Komunës së Gjilanit, me zotësi të veprimit të cilët kanë siguruar së paku 1000 (njëmijë) nënshkrime. **Iniciativa duhet të jetë në harmoni me listën e miratuar për figurat dhe ngjarjet meritore.**
- 1.2.** të ketë vlerësim nga Këshilli i Përhershëm Komunal, i përbërë nga profesionistë të cilët merren me vlerësimin e meritave të dëshmorëve, heronjve, martirëve, viktimave dhe kontribut dhënësve në secilën fushë të jetës shoqërore dhe profesionale të Komunës.
- 1.3.** duhet të ekzistojnë fakte të qëndrueshme të cilat janë të karakterit historik, arsimor, kulturor, profesional etj.
- 1.4. të ketë projekt ideor për vendosje të përmendoreve, shtatoreve, busteve dhe simboleve, por të ketë edhe arsyetimin duke përshkruar qëllimin kryesor për vendosje në hapësirat publike.
- 1.5. të ketë leje urbanistike nga organi kompetent komunal.
- 1.6. të ketë vendim nga ana e KK-së për dhënien e pëlqimit.

Neni 4

1. Këshilli i përhershëm komunal për vlerësim të meritave historike e shoqërore të personaliteteve dhe ngjarjeve nga territori i Komunës së Gjilanit dhe tërësia etnike shqiptare, por edhe nga tërë bota miraton listën dhe prioritetin e trajtimit të figurave dhe të ngjarjeve e të cilat figura mund të jenë nga ma të ndryshmet.
2. Lista miratohet nga Kuvendi i Komunës dhe mbetet në fuqi deri në revidimin e saj të ardhshëm nga KK-ja.

Neni 5

Vendosja e përmendoreve, shtatoreve, busteve dhe simboleve

1. Iniciativën për vendosjen e përmendoreve, shtatoreve, busteve ose të simboleve mund ta paraqesin edhe personat juridik dhe **organizatat ndryshme që veprojnë në territorin e Komunës së Gjilanit**. Iniciativa i dorëzohet Këshillit Komunal për vlerësim të meritave historike e shoqërore të personaliteteve dhe ngjarjeve nga hapësirat e Komunës, hapësirave shqiptare dhe nga tërë bota.
2. Këshillit Komunal për vlerësim të meritave historike dhe shoqërore të personaliteteve dhe ngjarjeve nga hapësira e Komunës, hapësirës shqiptare dhe nga bota, gjatë përcaktimit të propozimit përfundimtar për vendosjen e përmendoreve, shtatoreve, busteve dhe simboleve, duhet të bashkëpunojë ngushtë **me kryetarin e Komunës, kryesuesin e Kuvendit dhe** Ekzekutivin e Komunës për të zhvilluar procedurat dhe siguruar dokumentacionin e nevojshëm.
3. Komiteti për Politikë dhe Financa, pas pranimit të propozimit nga këshilli i përhershëm komunal për vlerësim të meritave historike e shoqërore të personaliteteve dhe ngjarjeve nga territori i Komunës së Gjilanit dhe tërësia etnike shqiptare, por edhe nga tërë bota për vendosjen e përmendoreve, shtatoreve, busteve, apo simboleve në parim konstaton se janë plotësuar kushtet sipas kësaj rregulloreje për vendosje dhe i propozon Kuvendit të Komunës që të merr vendim përfundimtar.

Neni 6

Për vendosjen e përmendoreve, shtatoreve, busteve dhe simboleve në vendet publike, vendimin përfundimtar e merr Kuvendi i Komunës, në pajtim me propozimin e Komitetit për Politikë dhe Financa.

Neni 7

Përgjegjësitë e Komunës

- V. Komuna si autoritet publik dhe përgjegjës, është e obliguar:
- 1.1. që të bëjë investim dhe bashkë investim me familjarët, shoqatat etj, në ngritjen e përmendoreve, shtatoreve, busteve dhe simboleve,
 - 1.2. që t'i mirëmbajë përmendoret, shtatoret, bustet dhe simbolet të cilat janë të vendosura në hapësira publike.
 - 1.3. të ndërmerr masa për mbrojtje të ambientit për rreth tyre të sugjeruara nga organi kompetent komunal, në pajtim me ligjin dhe aktet nënligjore.
 - 1.4. të njoftojë me shkrim organet kompetente në lidhje me trashëgiminë kulturore për statusin e përmendoreve, shtatoreve, busteve dhe simboleve.

Neni 8

Regjistri i përmendoreve, shtatoreve, busteve dhe simboleve

Të gjitha përmendoret, shtatoret, bustet dhe simbolet, duhet të regjistrohen në regjistër të posaçëm, të cilin e mbanë Drejtoria për Shërbime Publike edhe Arkivi Komunal ose Rajonal, ose organi tjetër i përcaktuar me ligj.

Neni 9

Mirëmbajtja dhe mbrojtja

1. Punët të cilat duhet të ndërmerren me qëllim të restaurimit të përmendoreve, shtatoreve, busteve dhe simboleve, mund të kryhen

vetëm me leje të organit kompetent, respektivisht Kuvendit të Komunës, nëse ndryshe nuk është përcaktuar me ligj.

2. Punimet që në një mënyrë ndryshojnë pamjen e përmendores, shtatores, bustit apo të simboleve dhe qëllimin për çka është vendosur, mund të kryhen me pëlqim të organit kompetent sipas paragrafit 1 të këtij neni ose nga komisioni i autorizuar nga ai.

Neni 10

Në rast se pronari i një përmendoreje, shtatoreje, busti ose simboli, është i panjohur ose ka pushuar së ekzistuari dhe se mbrojtja e tyre është me interes publik, atëherë Komuna dhe **MKRS, apo organi tjetër i autorizuar me ligj** i merr ato nën mbikëqyrje.

Dispozitat ndëshkuese

Neni 11 Gjobat

1. Me gjobë do të dënohet subjekti të cilit i janë besuar punët e mirëmbajtjes së përmendoreve, shtatoreve, busteve ose simboleve edhe atë:

personi fizik në shumë deri në 500 (pesëqind) € dhe personi juridik deri në 1000 (njëmijë) €, në rast se:

- 1.1. nuk i përmbahet masave mbrojtëse të përcaktuara nga organi përkatës në pajtim me ligjin dhe i cili është i autorizuar për mirëmbajtje;
- 1.2. **merr iniciativë për punë** në lidhje me mirëmbajtjen, restaurimin apo mbrojtjen pa pëlqim të organit kompetent dhe
- 1.3. pa vendim apo kundër vendimit të Kuvendit të Komunës, ndërmerren punime që në një mënyrë e ndërrojnë qëllimin dhe karakterin e përmendores, shtatores, bustit apo të simbolit të vendosur në hapësirë publike.

Neni 12

Gjoha e përcaktuar për persona fizik sipas nenit paraprak zbatohet edhe ndaj qytetarëve të cilët nuk kanë kujdes ose ndërmarrin veprime që i dëmtojnë përmendoret, shtatoret, bustet dhe simbolet.

V. DISPOZITAT KALIMTARE DHE PËRFUNDIMTARE

Neni 13

Trajtimi

1. Me këtë rregullore, të gjitha përmendoret, shtatoret, bustet dhe simbolet e vendosura në hapësira publike deri në miratimin e kësaj rregulloreje brenda territorit të Komunës, do të konsiderohen sipas dispozitave të kësaj rregulloreje dhe do të trajtohen njësoj sa i përket mirëmbajtjes së tyre.
2. Përmendoret, shtatoret, bustet dhe simbolet të cilat gjenden jashtë hapësirave publike (varrezat, objektet fetare dhe hapësirat për rreth objekteve fetare dhe hapësirat private) nuk janë objekt i kësaj rregulloreje.

Neni 14

Zhvendosja

Zhvendosja e përmendoreve, shtatoreve, busteve dhe simboleve nga lokacioni ekzistues në një lokacion tjetër, mund të bëhet vetëm me vendim të Kuvendit të Komunës, sipas iniciativës të paraqitur në pajtim me këtë rregullore të arsyetuar mirë dhe pasi që e njëjta të ketë kaluar në fazat e shqyrtimit dhe diskutimit publik.

Neni 15

Evidentimi

1. Autorizohet Drejtoria e Shërbimeve Publike, që të bëjë evidentimin e të gjitha përmendoreve, shtatoreve, busteve dhe simboleve të vendosura në hapësirat publike para dhe pas hyrjes në fuqi të kësaj rregulloreje.

Evidentimi duhet të bëhet në afat prej 90 ditësh nga dita e miratimit të kësaj rregulloreje.

2. Lista e përmendoreve, shtatoreve, busteve dhe simboleve të evidentuara do të jetë pjesë e kësaj rregulloreje.
3. Pjesë e kësaj rregulloreje do të jetë edhe lista e hapësirave publike në të cilat mund të bëhet vendosja e përmendoreve, shtatoreve, busteve dhe simboleve.

Neni 16

1. Kjo rregullore do të hynë në fuqi me miratimin nga KK-ja dhe nënshkrimin e saj nga kryesuesi i KK-së.
2. Rregullorja pas miratimit duhet të publikohet në ueb faqen e Komunës.

01. nr. 16-16481
Gjilan më 09.02.2012

Kuvendi i Komunës

Izmi ZEKA, Kryesues